

QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT

NË PROGRAMET E PARTIVE POLITIKE



ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE
28 DHJETOR 2025



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

17/2025

Autorë: Gzim Shala dhe Qemajl Marmullakaj

Me kontribut të: Melos Kolshi

Ekipi redaktues: Betim Musliu dhe Naim Jakaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

:

Përkrahur nga:

IKD

Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

Email: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org



Dhjetor 2025

Prishtinë, Republika e Kosovës

Lista e shkurtesave

LVV – Lëvizja Vetëvendosje!

PDK – Partia Demokratike e Kosovës

LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

KPM – Komisioni i Pavarur për Media

RTK – Radio Televizioni i Kosovës

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPMSHCK – Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

APK – Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit

BE – Bashkimi Evropian

IKD – Instituti i Kosovës për Drejtësi

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	7
2. Sfondi	9
3. Metodologjia e vlerësimit	9
4. Vlerësimi i programeve politike	11
a. Vlerësimi i përgjithshëm	11
b. Vlerësimi në fushën e Sundimit të Ligjit	12
c. Vlerësimi në fushën e Qeverisjes së Mirë.....	13
d. Vlerësimi sipas indikatorëve specifik	14
5. Programi politik i AAK.....	18
6. Programi politik i LDK	20
7. Programi politik i LVV	22
8. Programi politik i PDK	24
9. Annex 1: Tabela e plotë e vlerësimit.....	26
10. Annex 2: Indikatorët për vlerësimin e programeve të partive politike	27

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet një vlerësim të strukturuar dhe krahasues të programeve politike të partive kryesore pjesëmarrëse në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025, me fokus të veçantë në dy shtylla themelore: Qeverisjen e Mirë dhe Sundimin e Ligjit.

Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë se në çfarë mase dhe në çfarë mënyre programet politike adresojnë çështjet kyçe që ndërlidhen me qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, duke ofruar një pasqyrë objektive dhe të matshme për qytetarët që do të votojnë në zgjedhjet e 28 dhjetorit.

Raporti nuk vlerëson oportunitetin apo përshtatshmërinë politike të masave të propozuara, por fokusohet ekskluzivisht në shtrirjen, nivelin e elaborimit dhe strukturimin e angazhimeve programore, në raport me indikatorët e paracaktuar dhe të aplikuar në mënyrë uniforme në raport me programet e katër (4) partive politike. Indikatorët janë ndërtuar mbi bazën e parimeve të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit si dhe problemeve të identifikuara ndër vite përmes raporteve vendore, ndërkombëtare, raportet dhe analizat e IKD etj.

Indikatorët janë përzgjedhur mbi bazën e raporteve të Komisionit Evropian, obligimeve që rrjedhin nga MSA dhe analizave të IKD-së, duke reflektuar elementet kyçe të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit që pritet të adresohen në programet politike.

Rezultatet e vlerësimit tregojnë se asnjë nga programet politike nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të matshme për avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit. Në shumicën e rasteve, angazhimet mbesin në nivel të përgjithshëm ose deklarativ, pa u shoqëruar me masa konkrete, afate kohore dhe rezultate të pritshme. Në tërësi, programet politike kanë trajtuar disi më mirë elemente të Qeverisjes së Mirë, veçanërisht digjitalizimin, ndërsa Sundimi i Ligjit mbetet fusha më dobët, sidomos në raport me vetingun, luftën kundër korrupsionit dhe reformën strukturore të sistemit të drejtësisë.

Bazuar në poentimin e përgjithshëm prej 50 pikësh, renditja e programeve politike është si në vijim: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) renditet e para me 13 pikë, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 11 pikë, Lëvizja Vetëvendosje! (LVV) me 9 pikë, ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) renditet e fundit me 6 pikë. Diferencat në poentim janë relativisht të vogla dhe reflektojnë më shumë përfshirjen ose mungesën e trajtimit të disa indikatorëve specifikë, sesa ekzistencën e planeve të mirëfillta reformuese.

Në analizë krahasuese sipas indikatorëve, AAK qëndron relativisht më mirë në transparencë dhe llogaridhënie, si dhe në pavarësinë e mediave, ndonëse në nivel të kufizuar. LDK dallohet në depolitizimin e administratës publike dhe paraqet qasjen më të strukturuar në digjitalizim dhe qeverisje elektronike. LVV dhe AAK trajtojnë më mirë barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, por pa qasje gjithëpërfshirëse. PDK nuk shfaq indikatorë ku të dallohet në mënyrë të theksuar, duke trajtuar vetëm pjesërisht digjitalizimin dhe në mënyrë të kufizuar barazinë gjinore dhe të drejtat e

njeriut. Në fushën e Sundimit të Rendit dhe Ligjit, dallimet ndërmjet partive janë minimale, pasi asnjëra nuk ofron qasje të qartë dhe të strukturuar reformuese.

Në këtë raport, pos vlerësimeve të përgjithshme, paraqiten edhe vlerësimet në fushën përkatëse, vlerësimet sipas indikatorëve dhe vlerësimet narrative të secilit program politik i cili është objekt i vlerësimit të këtij raporti.

2. Sfondi

Kosova mbajti zgjedhjet e rregullta parlamentare më 9 shkurt 2025, por për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe ndarjeve të mëdha të mes partive politike, mos respektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga fituesja e këtyre zgjedhjeve LVV, procesi i konstituimit të Kuvendit u prolongua për muaj të tërë që më pas rezultoi me dështimin për të formuar Qeverinë dhe institucione funksionale. Tentativat e përsëritura për konstituimin e Kuvendit u shoqëruan me kontestime politike, juridike, duke rezultuar në një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese që përcaktuan parametrat kushtetues të këtij procesi. Pas krizës disa mujore institucionale dhe dështimit për përzgjedhjen e Qeverisë, Presidentja e Republikës së Kosovës shpërndau Kuvendin dhe shpalli zgjedhjet e jashtëzakonshme më 28 dhjetor 2025.

Në këtë kontekst institucional të tejzgjatur dhe në mungesë të qeverisjes funksionale, programet politike të partive marrin një rëndësi të posaçme, pasi ato paraqesin orientimet e tyre qeverisëse, angazhimet publike dhe pritshmëritë që i ofrohen qytetarëve. Ato përbëjnë dokumentin kryesor përmes të cilit partitë politike paraqesin ofertën e tyre ndaj qytetarëve.

Duke u mbështetur në mandatin e saj ligjor dhe profesional për monitorimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), përmes Programit Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja e Mirë, ka realizuar një vlerësim gjithëpërfshirës të programeve politike të partive kryesore pjesëmarrëse në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025. Vlerësimi është fokusuar në dy shtylla themelore—qeverisjen e mirë dhe sundimin e rendit dhe ligjit—duke siguruar një qasje të unifikuar, të standardizuar dhe të matshme përmes një seti indikatorësh të zhvilluar posaçërisht për këtë qëllim. Këta indikatorë do të shërbejnë si bazë objektive për matjen e cilësisë, koherencës dhe realizueshmërisë së angazhimeve programore të partive politike në raport me standardet e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit.

3. Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar mbi bazën e një qasje të standardizuar të vlerësimit të programeve politike, duke aplikuar një set të indikatorëve, të draftuar paraprakisht, të cilët janë aplikuar në mënyrë të njëjtë për vlerësimin e të gjitha programeve të partive politike. Indikatorët janë zhvilluar për të mundësuar një vlerësim real, të matshëm dhe të krahasueshëm të mënyrës se si programet politike trajtojnë çështjet që ndërlidhen me Qeverisjen e Mirë dhe Sundimin e Ligjit. Lista e detajuar e indikatorëve është pjesë e aneksit 2 të këtij raporti.

Indikatorët janë ndërtuar duke marrë për bazë parimet themelore të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit si dhe mbi bazën e problemeve të identifikuara ndër vite përmes raporteve vendore dhe ndërkombëtare, analizave tematike si dhe raporteve, hulumtimeve dhe analizave të publikuara nga IKD. Po ashtu, gjatë hartimit të indikatorëve është marrë parasysh nevoja e evidentuar për ndërhyrje në fusha specifike, të cilat, në mënyrë të arsyeshme, vlerësohet se kërkojnë zgjidhje programore nga subjektet politike që synojnë të qeverisin vendin.

Indikatorët e përdorur në këtë raport janë përzgjedhur mbi bazën e një analize të dokumenteve kyçe vendore dhe ndërkombëtare që adresojnë qeverisjen e mirë dhe sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. Konkretisht, indikatorët janë ndërtuar duke u mbështetur në raportet e Komisionit Evropian për Kosovën, obligimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA). Po ashtu, gjatë përzgjedhjes së indikatorëve janë marrë parasysh gjetjet dhe rekomandimet e raporteve dhe analizave të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), të zhvilluara ndër vite. Nga këto burime janë identifikuar çështjet që, në aspekt konceptual dhe praktik, përbëjnë elemente thelbësore të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, dhe që në mënyrë të arsyeshme pritet të adresohen përmes programeve politike.

Vlerësimi është aplikuar në raport me katër partitë politike kryesore që kanë publikuar programet e tyre qeverisëse: LVV, LDK, PDK dhe AAK. Nisma Socialdemokrate nuk është përfshirë në vlerësim, për shkak se nuk ka publikuar program qeverisës.

Raporti nuk trajton oportunitetin e zgjidhjeve të propozuara dhe nuk synon të jap analizë në lidhje me adekuatshmërinë e masave që përfshihen në programet e partive politike. Qasja e ndjekur fokusohet ekskluzivisht në shtrirjen e elaborimit dhe mënyrën se si trajtohen çështje të caktuara në programet politike në raport me indikatorët e aplikuar. Në këtë kuptim, raporti nuk vlerëson nëse një masë është e drejtë apo e gabuar, por vlerëson nëse dhe sa është trajtuar ajo në program dhe nivelin e konkretizimit të saj.

Raporti nuk shtrihet në fusha të tjera të politikëbërjes publike, por fokusohet vetëm në Qeverisjen e Mirë dhe Sundimin e Ligjit, si dy fusha në të cilat IKD ka ekspertizë të konsoliduar.

Indikatorët e vlerësimit janë të ndarë në dy shtylla:

Qeverisja e Mirë (5 indikatorë):

1. Barazia gjinore dhe të drejtat e grave në programin qeverisës;
2. Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë;
3. Depolitizimi i administratës publike;
4. Digjitalizimi dhe qeverisja elektronike;
5. Pavarësia e mediave.

Sundimi i Rendit dhe Ligjit (5 indikatorë):

1. Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë;
2. Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit;
3. Integriteti i Prokurimit Publik;
4. Vetingu në drejtësi;
5. Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Poentimi është bërë në shkallën 0–5 për secilin indikator:

0 = Nuk përmendet;

1 = Deklaratë e përgjithshme;

3 = Përmendet me masa specifike por jo të plotë dhe pa plan të strukturuar zbatim;

5 = Plan gjithëpërfshirë, i qartë dhe i matshëm.

Në bazë të këtij poentimi, raporti jep vlerësimin e përgjithshëm, vlerësimin për Qeverisjen e Mirë, vlerësimin për Sundimin e Rendit dhe Ligjit, si dhe vlerësimin sipas secilit indikator, duke elaboruar në secilin rast aspektet konkrete që kanë bërë diferencën ndërmjet programeve politike.

4. Vlerësimi i programeve politike

a. Vlerësimi i përgjithshëm

Vlerësimi i përgjithshëm i programeve politike është realizuar mbi bazën e vlerësimit të standardizuar të programeve përmes setit të indikatorëve të zhvilluar posaçërisht për këtë raport, sipas metodologjisë së prezantuar më lart. Vlerësimi ka synuar të masë shkallën në të cilën programet politike adresojnë në mënyrë konkrete, të qartë dhe të matshme çështjet kryesore që lidhen me Qeverisjen e Mirë dhe Sundimin e Ligjit. Në këtë kuptim, vlerësimi ka për objekt nivelin e përmbajtjes së programeve politike në kontekst të indikatorëve të aplikuar. Siç u theksua, nuk është vlerësuar oportuniteti i masave; përkatësisht, raporti nuk vlerëson nëse masat e prezantuara në programet e partive politike janë adekuate apo jo, por është fokusuar në mënyrën e prezantimit dhe elaborimit të tyre.

Në rezultatin e përgjithshëm, programet politike kanë marrë vlerësime kryesisht të ulëta, çka tregon se, në tërësi, programet kanë pasur mungesë të masave të strukturuar, mungesë të qartësisht të mënyrës së arritjes së zotimeve, mungesë të afateve dhe rezultateve të pritshme. Në shumicën e rasteve, qasja ndaj temave është shfaqur më shumë përmes zotimeve të përgjithshme sesa përmes planeve konkrete të reformës.

Bazuar në poentimin e përgjithshëm prej 50 pikësh, renditja është si në vijim:

1. **Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)** – 13 pikë;
2. **Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)** – 11 pikë;
3. **Lëvizja Vetëvendosje! (LVV)** – 9 pikë;
4. **Partia Demokratike e Kosovës (PDK)** – 6 pikë.

Diferencat në total, megjithëse ekzistojnë, mbeten të kufizuara dhe reflektojnë më shumë faktin se një program ka trajtuar disa indikatorë shtesë që nuk janë trajtuar nga programe të tjera, sesa faktin se ndonjëri prej programeve ka paraqitur një qasje të plotë dhe të matshme. Thënë ndryshe, asnjëri prej programeve nuk trajton në mënyrë adekuate dhe nuk merr vlerësim, qoftë edhe relativisht, të lartë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit.

Në aspektin e ndarjes sipas dy shtyllave, vlerësimi tregon një prirje të përgjithshme: programet kanë trajtuar disi më mirë elemente të Qeverisjes së Mirë, ndërsa Sundimi i Ligjit është trajtuar më dobët dhe më deklarativisht. Megjithatë, edhe brenda Qeverisjes së Mirë, rezultatet nuk tregojnë qasje gjithëpërfshirëse, pasi shumica e programeve janë fokusuar në vetëm disa fusha të veçanta, ndërsa kanë lënë jashtë ose kanë trajtuar minimalisht çështje të rëndësishme si transparenca, depolitizimi i administratës dhe pavarësia e mediave.

Në përfundim, vlerësimi i përgjithshëm tregon se programet politike, në tërësi, nuk arrijnë të paraqesin plane të qarta dhe të matshme për reforma në dy shtyllat kryesore të këtij vlerësimi. Për rrjedhojë, raporti konstaton se programet e partive politike nuk ofrojnë platforma të qarta, të strukturuar dhe të detajuara në lidhje me vizionin e tyre për avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit në Kosovë.

b. Vlerësimi në fushën e Sundimit të Ligjit

Në tërësi, vlerësimi tregon se fusha e Sundimit të Ligjit është trajtuar dobët nga të gjitha programet politike, me dallime relativisht të kufizuara ndërmjet subjekteve. Asnjë program politik nuk arrin të prezantojë një qasje gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të matshme për reformat në këtë fushë, ndërsa shumica e zotimeve mbetin në nivel të përgjithshëm ose deklarativ.

Bazuar në poentimin e përgjithshëm prej 25 pikëve të mundshme në këtë fushë, renditja është si në vijim:

1. **AAK – 3 pikë**
2. **LDK – 3 pikë**
3. **LVV – 3 pikë**
4. **PDK – 2 pikë**

Diferencimi në këtë shtyllë është ndikuar kryesisht nga trajtimi i reformës në drejtësi dhe nga mënyra se si programet e trajtojnë luftën kundër korrupsionit, vetingun dhe, pjesërisht, të drejtat e njeriut. Në këtë drejtim, asnjëri prej programeve politike nuk e adreson procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë.

Po ashtu, edhe në indikatorë të tjerë, përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe integritetin e prokurimit publik, programet përgjithësisht nuk paraqesin plane të qarta reformuese, por mbesin në zotime të përgjithshme ose në përmendje sporadike pa strukturë të qartë reformuese.

Në përfundim, vlerësimi në fushën e Sundimit të Ligjit tregon se asnjë program politik nuk arrin të adresojë në mënyrë adekuate dhe strukturore reformat e nevojshme në këtë fushë, sipas indikatorëve të aplikuar. Diferencat në renditje janë më shumë rezultat i përmendjes së disa elementeve të përgjithshme deklarative apo të pastrukturuara sesa i ekzistencës së planeve të qarta reformuese.

c. Vlerësimi në fushën e Qeverisjes së Mirë

Në tërësi, vlerësimi tregon se programet politike kanë trajtuar më shumë elemente të Qeverisjes së Mirë sesa të Sundimit të Ligjit, por jo në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strukturore. Shumica e programeve kanë theksuar disa fusha të caktuara, veçanërisht digjitalizimin, ndërsa fusha të tjera kyçe si transparenca, depolitizimi i administratës dhe pavarësia e mediave janë trajtuar pak ose janë lënë jashtë.

Bazuar në poentimin e përgjithshëm prej 25 pikëve të mundshme në këtë fushë, renditja është si në vijim:

1. **AAK – 10 pikë;**
2. **LDK – 8 pikë;**
3. **LVV – 6 pikë;**
4. **PDK – 4 pikë.**

Ky rezultat reflekton faktin se, në këtë shtyllë, diferencimi është ndikuar kryesisht nga dy fusha: (i) digjitalizimi, ku disa programe kanë paraqitur masa më të strukturuara, dhe (ii) transparenca, ku vetëm një program ka përmendur disa masa më specifike. Në të njëjtën kohë, mungesa e trajtimit të depolitizimit të administratës publike, me përjashtim të programit të LDK, dhe pavarësisë së mediave ka ulur ndjeshëm poentimin e shumicës së programeve.

Në aspektin e përmbajtjes, vlerësimi tregon se barazia gjinore trajtohet pjesërisht nga disa programe, por pa u shndërruar në qasje gjithëpërfshirëse. Transparenca dhe llogaridhënia trajtohen minimalisht, me përjashtim të programit të AAK që ka një vlerësim mesatar, ndërsa depolitizimi i administratës publike mbetet pothuajse i paadresuar, me përjashtim të programit të LDK, që merr një vlerësim mesatar. Digjitalizimi është fusha më e trajtuar, por jo gjithmonë si reformë e integruar e qeverisjes elektronike. Në mënyrë të plotë dhe të strukturuar këtë e bënë vetëm programi i LDK. Pavarësia e mediave, me përjashtim të trajtimit minimal nga program i AAK, mbetet e patrajtuar nga programet e partive të tjera.

Në përfundim, vlerësimi në fushën e Qeverisjes së Mirë tregon se programet politike përmbajnë disa elemente më të prekshme sesa në Sundimin e Ligjit, por mbeten larg një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të matshme për avancimin e qeverisjes së mirë në Kosovë.

d. Vlerësimi sipas indikatorëve specifik

Indikatori 1: Barazia gjinore dhe të drejtat e grave në programin qeverisës

Në raport me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **LVV – 3 pikë**
2. **AAK – 3 pikë**
3. **PDK – 1 pikë**
4. **LDK – 0 pikë**

Vlerësimi tregon se kjo fushë trajtohet në mënyrë të pjesshme dhe jo të plotë nga shumica e programeve politike. Programet e LVV-së dhe AAK-së përmbajnë disa elemente konkrete, kryesisht në raport me punësimin e grave dhe mbrojtjen nga dhuna, por pa ndërtuar një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, buxhetimin gjinor dhe mekanizmat e qartë të zbatimit. Programi i PDK-së e trajton këtë fushë vetëm në mënyrë shumë të kufizuar, kryesisht përmes përmendjes së përkrahjes për lehonat, pa u shtrirë në fusha të tjera të barazisë gjinore dhe pa elaborim të strukturuar. Programi i LDK-së nuk e adreson fare këtë fushë, çka reflektohet drejtpërdrejt në vlerësim.

Indikatori 2: Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë

Në raport me transparencën dhe llogaridhënien, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **AAK – 3 pikë**
2. **LDK – 0 pikë**
3. **LVV – 0 pikë**
4. **PDK – 0 pikë**

Vlerësimi tregon se transparenca dhe llogaridhënia nuk trajtohen në mënyrë të strukturuar nga shumica e programeve politike. Vetëm programi i AAK-së përmban disa referenca më konkrete, veçanërisht në raport me konsultimet dhe platformat e transparencës, ndonëse pa elaborim të mjaftueshëm. Programet e LDK-së, LVV-së dhe PDK-së nuk e trajtojnë këtë fushë në aspektin programor.

Indikatori 3: Depolitizimi i administratës publike

Në raport me depolitizimin e administratës publike, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **LDK – 3 pikë**
2. **LVV – 0 pikë**
3. **AAK – 0 pikë**
4. **PDK – 0 pikë**

Vlerësimi tregon se depolitizimi i administratës publike është një nga fushat më pak të adresuara nga programet politike. Vetëm programi i LDK-së përmban disa elemente që lidhen me kufizimin plotësimin e pozitave dhe mos mbajtjen e tyre me ushtrues detyre, por pa ndërtuar një qasje të plotë dhe të strukturuar për depolitizimin e administratës publike. Programet e tjera nuk e adresojnë fare këtë fushë.

Indikatori 4: Digjitalizimi dhe qeverisja elektronike

Në raport me digjitalizimin dhe qeverisjen elektronike, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **LDK – 5 pikë**
2. **LVV – 3 pikë**
3. **AAK – 3 pikë**
4. **PDK – 3 pikë**

Vlerësimi tregon se digjitalizimi është fusha më e trajtuar në kuadër të Qeverisjes së Mirë. Programi i LDK-së dallohet për trajtimin më të strukturuar dhe më të detajuar të kësaj fushe. Programet e LVV-së dhe AAK-së përmbajnë disa masa sektoriale, por pa ndërtuar një qasje të unifikuar të qeverisjes elektronike. Programi i PDK-së e trajton digjitalizimin në disa fusha specifike, si drejtësia, shëndetësia dhe arsimi, por pa paraqitur plan konkret dhe të integruar për qeverisjen elektronike.

Indikatori 5: Pavarësia e mediave

Në raport me pavarësinë e mediave, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **AAK – 1 pikë**

2. **LDK – 0 pikë**

3. **LVV – 0 pikë**

4. **PDK – 0 pikë**

Vlerësimi tregon se pavarësia e mediave mbetet ndër fushat më pak të adresuara nga programet politike. Programi i AAK-së përmban disa zotime më të drejtpërdrejta, por pa qartësuar ndërhyrjet ligjore dhe institucionale. Programet e tjera nuk e trajtojnë fare këtë fushë në mënyrë programore.

SUNDIMI I RENDIT DHE LIGJIT

Indikatori 6: Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë

Në raport me reformën ligjore në sistemin e drejtësisë, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **LDK – 1 pikë**

2. **LVV – 1 pikë**

3. **AAK – 1 pikë**

4. **PDK – 1 pikë**

Vlerësimi tregon se asnjë program politik nuk paraqet një qasje të qartë, të strukturuar dhe të matshme për reformimin e sistemit të drejtësisë. Reforma në drejtësi trajtohet në mënyrë deklarative, pa identifikim të ligjeve konkrete, pa afate kohore dhe pa referenca ndaj proceseve aktuale të reformës në sistemin e drejtësisë.

Indikatori 7: Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit

Në raport me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **LDK – 1 pikë**

2. **AAK – 1 pikë**

3. **LVV – 0 pikë**

4. **PDK – 0 pikë**

Vlerësimi tregon se lufta kundër korrupsionit trajtohet kryesisht në mënyrë deklarative. Programet e LDK-së dhe AAK-së e trajtojnë këtë fushë në nivel të përgjithshëm, ndërsa programet e LVV-së dhe PDK-së nuk e adresojnë fare si politikë të veçantë.

Indikatori 8: Integriteti i Prokurimit Publik

Në raport me integritetin e prokurimit publik, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **LDK – 1 pikë**
2. **LVV – 1 pikë**
3. **AAK – 0 pikë**
4. **PDK – 0 pikë**

Vlerësimi tregon se prokurimi publik përmendet vetëm në mënyrë të përgjithshme nga disa programe politike, pa masa konkrete dhe pa adresim të problematikave kyçe. Programet e AAK-së dhe PDK-së nuk e trajtojnë fare këtë fushë në mënyrë programore.

Indikatori 9: Vetingu në drejtësi

Në raport me vetingun në drejtësi, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **LDK – 0 pikë**
2. **LVV – 0 pikë**
3. **AAK – 0 pikë**
4. **PDK – 0 pikë**

Vlerësimi tregon se vetingu në drejtësi, si një prej reformave më të diskutuara, nuk trajtohet nga asnjë prej programeve politike në mënyrë programore dhe të strukturuar.

Indikatori 10: Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Në raport me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, renditja e subjekteve politike në bazë të poentimit është si në vijim:

1. **LVV – 1 pikë**
2. **AAK – 1 pikë**
3. **PDK – 1 pikë**
4. **LDK – 0 pikë**

Vlerësimi tregon se kjo fushë trajtohet në mënyrë shumë të kufizuar nga shumica e programeve politike. Programi i PDK-së përmban disa përmendje të përgjithshme, si ndihma juridike falas dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore, por pa elaborim dhe pa strukturim të masave. Programet e LVV-

së dhe AAK-së e trajtojnë këtë fushë vetëm pjesërisht, ndërsa programi i LDK-së nuk e adreson fare këtë indikator në mënyrë programore.

5. Programi politik i AAK

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka publikuar programin e saj qeverisës për periudhën 2026–2029, i cili është i ndarë në kapituj tematikë. Në aspektin e organizimit, programi ka një shtrirje të gjerë sektoriale, por në shumë fusha kyç për qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, mbetet më shumë në nivel të orientimeve dhe zotimeve të përgjithshme, sesa në masa të detajuara dhe të matshme.

Bazuar në metodologjinë e vlerësimit dhe indikatorët e përcaktuar në këtë raport, programi politik i AAK-së ka marrë një vlerësim mesatar në Qeverisje të Mirë dhe një vlerësim të ulët në Sundim e Ligjit. Në ndarje sipas shtyllave, nga 25 pikë të mundshme në fushën e Qeverisjes së Mirë, programi është vlerësuar me 10 pikë, ndërsa në fushën e Sundimit të Ligjit, nga 25 pikë të mundshme, programi është vlerësuar me 3 pikë.

Vlerësimi në fushën e Qeverisjes së Mirë

Në indikatorin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, programi i AAK-së përmend disa çështje që i përgjigjen kësaj fushe si mbrojtja e grave, politikat për gratë si kategori e veçantë, promovimi i barazisë, përmirësimin e mundësive profesionale për gratë, strategjia gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e grave etj. Por, programi nuk specifikon qartë masat që do të ndërmerren, nuk e lidh këtë fushë me mekanizma të zbatimit dhe mbikëqyrjes, nuk paraqet afate dhe rezultate të pritshme etj. Pra, fusha përmendet dhe trajtohet në nivel politikash, por pa u shndërruar në plan të qartë veprimi që parashikon masat specifike dhe planin për realizimin e tyre.

Sa i përket transparencës dhe llogaridhënies, programi i AAK-së paraqet një qasje më pozitive. Për këtë, programi përmend instalimin e praktikave të konsultimeve dhe pjesëmarrjes aktive. Një element tjetër i rëndësishëm që përmendet është instalimi i një mekanizmi të pavarur nga institucionet, përmes të cilit mediet dhe shoqëria civile garojnë me projekte që përkrahin demokratizimin, progresin dhe zhvillimin institucional. Po ashtu, programi përmend edhe krijimin e një platforme kombëtare për transparencë në qeverisje, e cila do të lejonte monitorimin e shpenzimeve publike dhe projekteve të qeverisë në kohë reale, duke synuar rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Megjithatë listohen këto masa, kufizimi i transparencës në vetëm këto fusha dhe mos specifikimi i masave tjera specifike, që mundësojnë transparencë gjithëpërfshirëse, ka bërë që përkitazi me këtë indikator, vlerësimi të jetë mesatar.

Depolitizimi i administratës nuk është trajtuar nga programi i AAK.

Në indikatorin e digjitalizimit dhe qeverisjes elektronike, programi përmend digjitalizimin e shërbimeve publike, avancimin e platformave të e-qeverisjes, shtimin e e-shërbimeve, hartimin e një strategjie etj. Megjithatë, edhe këtu, qasja mbetet në nivel të listimit të disa masave të paspecifikuara në lidhje me atë se si do të duken këto masa në kuptim të integritimit, unifikimit, ndërveprueshmërisë së sistemeve, bashkëpunimin ndërinstitucional etj.

Sa i përket pavarësisë së mediave, programi e trajton këtë fushë në nivel të parimeve dhe zotimeve, duke përmendur avancimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e lirisë së medias dhe diversitetin mediatik, reformimin e transmetuesve publikë me qëllim forcimin e pavarësisë së tyre nga qeveria dhe instalimin e një mekanizmi të pavarur nga institucionet, përmes të cilit mediet dhe shoqëria civile garojnë me projekte që përkrahin demokratizimin, progresin dhe zhvillimin institucional e njerëzor. Megjithatë, programi nuk specifikon se si do të arrihet kjo në praktikë, cilat janë ndërhyrjet konkrete ligjore dhe institucionale. Po ashtu, programi e lë jashtë mënyrën se si do të adresohet çështja e KPM.

Vlerësimi në fushën e Sundimit të Rendit dhe Ligjit

Në fushën e Sundimit të Rendit dhe Ligjit, programi i AAK-së ka vlerësim të ulët prej 3 pikësh nga 25, kryesisht për shkak se një pjesë e indikatorëve nuk adresohen fare, ndërsa pjesa tjetër trajtohet vetëm në nivel deklarativ.

Së pari, programi nuk përmend asgjë në lidhje me vetingun në sistemin e drejtësisë. Po ashtu, programi nuk trajton reformën e prokurimit publik.

Sa i përket reformës në drejtësi, programi e thekson sundimin e ligjit dhe drejtësinë e pavarur, por mbetet në vlerësime të përgjithshme dhe pa qartësim të reformave ligjore që kërkohen. Nuk paraqiten masa konkrete, ligje specifike që synohen të ndryshohen, si dhe nuk shihen referenca ose orientime ndaj rekomandimeve të Komisionit të Venecias, Strategjisë për Sundimin e Ligjit apo dokumenteve të tjera relevante që e përcaktojnë drejtimin e reformave.

Në fushën e korrupsionit, programi përmban deklaramë të përgjithshme dhe zotime të paspecifikuara. Përmenden rritja e kapaciteteve, zhvillimi i kodeve të etikës, fuqizimi i institucioneve si dhe hartimi i një strategjie dhe plani veprimi kundër korrupsionit. Megjithatë, këto mbesin pa përshkrim konkret të masave.

Sa i përket të drejtave të njeriut, programi i referohet në mënyrë të përgjithshme mbështetjes së personave dhe kategorive me nevoja të veçanta. Megjithatë, në kuptimin e indikatorit të sundimit të ligjit, nuk paraqitet një plan i qartë për avancimin e të drejtave të njeriut në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Përfundim

Në tërësi, programi i AAK-së ka disa elemente më të dallueshme në fushën e Qeverisjes së Mirë, sidomos në raport me barazinë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave si dhe me transparencën dhe llogaridhënien ku përmenden disa masa specifike, por se të njëjtat nuk specifikohen tutje. Ndërkaq, në fushën e Sundimit të Ligjit, programi ka një vlerësim të ulët, ku mungon trajtimi i vetingut dhe reformës së prokurimit publik, ndërsa reforma në drejtësi dhe lufta kundër korrupsionit trajtohen kryesisht në mënyrë të përgjithshme dhe pa masa konkrete derisa në mënyrë shumë të kufizuar trajtohet aspekti i mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Këto mungesa kanë reflektuar drejtpërdrejt në vlerësimin e ulët të programit në këtë shtyllë.

6. Programi politik i LDK

LDK ka publikuar Programin e saj Qeverisës për zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit 2025, i cili përbëhet nga gjithsej 21 kapituj tematikë. Programi trajton një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë stabilitetin institucional, administratën publike, digjitalizimin, ekonominë, sigurinë, drejtësinë, arsimin, shëndetësinë etj.

Bazuar në metodologjinë e vlerësimit dhe indikatorët e përcaktuar në këtë raport, programi politik i LDK-së ka marrë një vlerësim përgjithësisht të ulët. Nga totali prej 50 pikësh, programi është vlerësuar me 11 pikë, çka tregon një nivel të kufizuar të adresimit të problematikave në fushën e Qeverisjes së Mirë dhe Sundimit të Rendit dhe Ligjit, sipas indikatorëve të aplikuar për këtë vlerësim.

Në ndarje sipas shtyllave, nga 25 pikë të mundshme në fushën e Qeverisjes së Mirë, programi i LDK-së është vlerësuar me 8 pikë. Ndërkaq, në fushën e Sundimit të Rendit dhe Ligjit, nga 25 pikë të mundshme, programi ka marrë vetëm 3 pikë, duke reflektuar mungesë të theksuar të masave konkrete në këtë fushë.

Vlerësimi në fushën e Qeverisjes së Mirë

Në fushën e Qeverisjes së Mirë, programi i LDK-së nuk adreson fare disa nga çështjet të cilat i përfshirjnë indikatorët e vlerësimit. Në mënyrë të veçantë, programi nuk përmend çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, nuk parasheh masa të qarta për transparencë dhe llogaridhënie qeveritare (ndonëse e përmend në kontekst të përgjithshëm) si dhe nuk trajton pavarësinë e mediave.

Sa i përket depolitizimit të administratës publike, programi i LDK-së paraqet disa elemente pozitive. Në mënyrë specifike, ai e identifikon problemin e qeverisjes me pozita ushtruese detyre, duke premtuar adresimin e kësaj situate përmes plotësimit të të gjitha pozitave vakante. Ky angazhim përbën një hap pozitiv drejt stabilizimit të administratës publike dhe reduktimit të ndërhyrjeve politike në administratën publike. Megjithatë, përtej këtij zotimi, programi nuk adreson një sërë çështjesh të tjera të rëndësishme në fushën e administratës publike. Nuk qartësohet, për shembull, nëse pozitat drejtuese të mesme dhe të ulëta do të kenë mandate të

përhershme apo të përkohshme, as nuk trajtohet roli dhe funksionimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPMShCK) dhe çështje të tjera relevante në këtë fushë.

Pika më e fortë e programit të LDK-së në fushën e Qeverisjes së Mirë lidhet me indikatorin e digjitalizimit dhe qeverisjes elektronike. Programi i LDK-së për këtë çështje përmban një kapitull të veçantë dhe të detajuar, ku parasheh masa dhe fusha konkrete ndërhyrjeve. Në këtë kontekst, programi synon fuqizimin e sektorit të teknologjisë së informacionit si dhe implementimin e zgjidhjeve digjitale në institucionet publike. Këto masa synojnë uljen e barrës administrative për qytetarët dhe bizneset, rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional, përmirësimin e transparencës dhe rritjen e efikasitetit institucional. Për këto arsye, ky indikator përbën kontribuesin kryesor në poentimin e LDK-së në këtë shtyllë.

Vlerësimi në fushën e Sundimit të Rendit dhe Ligjit

Në fushën e Sundimit të Ligjit, programi i LDK-së paraqet mangësi edhe më të theksuara. Programi nuk përmend fare procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë si dhe nuk trajton çështjen e të drejtave të njeriut si një fushë në të cilin nevojitet angazhim i theksuar i të gjitha institucioneve. Vetingu përmendet vetëm në raport me Policinë e Kosovës, por jo në raport me sistemin e drejtësisë, gjë që përjashton një nga reformat më të diskutuara në fushën e sundimit të ligjit.

Sa i përket reformës në drejtësi, programi i LDK-së kufizohet në përmendjen e aspekteve të përgjithshme të reformimit të sistemit, pa ofruar masa konkrete, pa identifikuar problematikat specifike dhe pa iu referuar rekomandimeve të Komisionit të Venecias, Strategjisë për Sundimin e Ligjit apo dokumenteve të tjera relevante. Reformimi i drejtësisë trajtohet më shumë si zotim politik sesa si proces i strukturuar dhe i matshëm.

Një qasje e ngjashme vërehet edhe në raport me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Programi nuk paraqet një analizë të qartë të problemit, as masa konkrete institucionale dhe ligjore për adresimin e tij, por kufizohet kryesisht në zotime të përgjithshme për luftimin e korrupsionit. Po ashtu, edhe në fushën e prokurimit publik, programi e përmend nevojën për reformë dhe e shoqëron këtë me premtime të tjera, por pa specifikuar saktësisht ndryshimin që nevojitet në këtë fushë.

Përfundim

Në tërësi, programi politik i LDK-së reflekton një qasje të përgjithshme zhvillimore, me theks të veçantë në digjitalizim dhe modernizim institucional. Megjithatë, në raport me indikatorët e këtij vlerësimi, ai shfaq mungesë të theksuar të masave konkrete, të strukturuar dhe të matshme, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit dhe në disa aspekte kyçe të qeverisjes së mirë. Kjo ka reflektuar drejtpërdrejt në poentimin e ulët të përgjithshëm të programit.

7. Programi politik i LVV

Programi politik i Lëvizjes Vetëvendosje! (LVV)

Lëvizja Vetëvendosje! ka publikuar programin e saj për zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit 2025, i cili është i strukturuar në disa blloqe tematike dhe i shtrirë në fusha të ndryshme të politikave publike. Programi trajton çështje që lidhen me zhvillimin ekonomik, energjinë, arsimin, shëndetësinë, bujqësinë etj. Në përmbajtje, programi ka shumë zotime të shpërndara nëpër sektorë, por jo gjithmonë i strukturon këto zotime si reforma institucionale me masa të matshme, sidomos në fushën e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë.

Bazuar në metodologjinë e vlerësimit dhe indikatorët e përcaktuar në këtë raport, programi politik i LVV-së ka marrë një vlerësim përgjithësisht të ulët, duke marrë vetëm 9 nga 50 pikë. Në fushën e Qeverisjes së Mirë, vlerësimi është 6 nga 25 pikë, ndërsa në fushën e Sundimit të Ligjit, vlerësimi është 3 nga 25 pikë. Kjo tregon se programi ka trajtuar vetëm pjesërisht disa tema, ndërsa shumë shumë të cilat mbulohen nga indikatorët e vlerësimit nuk janë trajtuar fare ose janë trajtuar vetëm në mënyrë shumë të përgjithshme.

Vlerësimi në fushën e Qeverisjes së Mirë

Në fushën e Qeverisjes së Mirë, programi i LVV-së nuk thotë asgjë për transparencën dhe llogaridhënien e Qeverisë dhe Kuvendit në kuptim të masave konkrete dhe veprimeve të strukturuar. Në mënyrë të ngjashme, programi nuk e trajton fare aspektin e depolitizimit të administratës publike e as pavarësinë e mediave.

Sa i përket barazisë gjinore dhe mbrojtjes së të drejtave të grave, programi paraqet një qasje më të strukturuar. Në këtë drejtim, platforma “Superpuna” është një element pozitiv dhe i veçantë, sepse paraqet një koncept të dedikuar dhe me masa konkrete për punësimin dhe pjesëmarrjen ekonomike, duke e trajtuar këtë si prioritet të politikave publike. Dhuna në familje përmendet në kontekst të arsytimit për themelimin e Gjykatës familjare. Megjithatë, pavarësisht se “Superpuna” paraqet një platformë specifike dhe konkrete, programit i mungojnë aspekte të tjera që kërkohen nga indikatorët, si p.sh. masat e qarta për barazinë gjinore në vendimmarrje, mekanizmat institucionalë për zbatimin e barazisë gjinore, politika të strukturuar për parandalimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore, qasje më e gjerë në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe instrumente të matshme të llogaridhënies në këtë fushë etj. Pra, megjithëse ka elemente të mira dhe të dallueshme, mbulimi i kësaj fushe mbetet i pjesshëm.

Në fushën e digjitalizimit dhe qeverisjes elektronike, programi përmban një numër çështjesh konkrete dhe shembujsh sektorialë, si p.sh. arkat fiskale digjitale, digjitalizimi në fushën e financave, digjitalizimi i disa shërbimeve si dhe iniciativa të tjera si “karta e-fermeri”. Megjithatë, edhe këtu, programi nuk e ndërton digjitalizimin si një reformë të integruar të qeverisjes elektronike, me platforma specifike të unifikuara, ndërveprim dhe bashkëpunim ndërinstitucional,

standarde të qarta dhe objektiva të matshme. Përfundimisht, në një masë, është fusha e drejtësisë ku digjitalizimi përmendet, por se edhe aty duhet pasur parasysh se pjesa kryesore e mandatit për rregullimin e brendshëm të sistemit gjyqësor është te institucionet e pavarura të drejtësisë (KGJK/KPK), dhe jo te Qeveria. Prandaj, edhe pse digjitalizimi përmendet në disa drejtime, programi nuk e trajton si reformë të plotë të qeverisjes elektronike.

Vlerësimi në fushën e Sundimit të Ligjit

Në fushën e Sundimit Ligjit, programi praktikisht nuk ofron fare program të strukturuar. Në pjesën për drejtësinë, përmbajtja është kryesisht e njëjtë me programin e mëparshëm të zgjedhjeve të 9 shkurtit ku nuk reflektohen zhvillimet aktuale në kuptim të reformës në drejtësi. Programi i LVV-së nuk bënë ndërlidhjen me reformën e sistemit të drejtësisë sipas deklaratës së përbashkët të zotimeve, rekomandimet e Komisionit të Venecias, Strategjinë për Sundimin e Ligjit etj.

Edhe kur përmenden disa ide (si themelimi i Gjykatës familjare, themelimi i një prokurorie të specializuar, ose një zyre për hetime disiplinore), këto shpesh mbesin jashtë kontekstit real institucional dhe pa analizë meritore. Mbetet i paraqartë premetimi për themelimin e një Prokurorie Speciale, duke pasur një të tillë në Kosovë, dy (2) ligje për të cilën janë votuar nga Qeveria e udhëhequr nga LVV. Njëjtë është edhe me llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku fusha disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve është reformuar në kuadër të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili nuk e përmbanë këtë Zyre. Kështu, në fushën e reformës në drejtësi, ndonëse përmenden disa masa, ato janë të shkëputura nga realiteti institucional dhe nga proceset reformuese të zhvilluara nga Qeveria e udhëhequr nga LVV. Prandaj, 1 pikë merret vetëm për faktin se disa çështje përmenden, e jo sepse paraqitet një plan i kuptueshëm, i strukturuar dhe i matshëm.

Në raport me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, programi nuk e trajton fare këtë fushë si politikë e veçantë.

Sa i përket prokurimit publik, programi e përmend vetëm në mënyrë të përgjithshme nevojën për reformim të sistemit të prokurimit publik, por pa specifikuar saktësisht problemin dhe masat e nevojshme që kërkohen nga indikatorët e këtij vlerësimi. Prandaj, vlerësimi mbetet minimal.

Ndërkaq, për të drejtat e njeriut, programi përmend kryesisht vetëm të drejtat që dalin nga marrëdhënia e punës, përmes rritjes së numrit të inspektorëve, por nuk e trajton këtë fushë si shtyllë të gjerë të sundimit të ligjit, me politika dhe masa të tjera konkrete (mosdiskriminim, mbrojtje të grupeve të cënueshme, mekanizma mbikëqyrës, zbatim standardesh, etj.). Për këtë arsye, edhe këtu vlerësimi mbetet minimal.

Përfundim

Në tërësi, programi i LVV-së paraqet një numër zotimesh sektoriale dhe disa iniciativa të veçanta pozitive në fushën e punësimit të grave si dhe disa elemente të digjitalizimit në sektorë të ndryshëm. Megjithatë, në raport me indikatorët e këtij vlerësimi, programi shfaq mungesë të theksuar të reformave të strukturuar dhe të matshme në qeverisjen e mirë (sidomos transparenca, depolitizimi i administratës dhe pavarësia e mediave) dhe, edhe më shumë, në sundimin e ligjit (reforma në drejtësi, korrupsioni, vetingu dhe trajtimi më substancial i të drejtave të njeriut). Kjo është reflektuar drejtpërdrejt në vlerësimin e përgjithshëm dhe në poentimin e ulët në të dy shtyllat.

8. Programi politik i PDK

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka publikuar programin e saj qeverisës për zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit 2025, i cili është i strukturuar në kapituj tematikë dhe trajton fusha të ndryshme të politikave publike. Në raport me fokusin e këtij vlerësimi, programi i PDK-së përmban vetëm disa përmendje në çështje që lidhen me qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, ku pjesa më e madhe e indikatorëve të aplikuar për qëllime të këtij vlerësimi nuk adresohen ose adresohen kryesisht vetëm në nivel deklarativ.

Bazuar në metodologjinë e vlerësimit dhe indikatorët e përcaktuar në këtë raport, programi politik i PDK-së ka marrë vlerësim të ulët. Në ndarje sipas shtyllave, nga 25 pikë të mundshme në fushën e Qeverisjes së Mirë, programi është vlerësuar me 4 pikë, ndërsa në fushën e Sundimit të Ligjit, nga 25 pikë të mundshme, programi është vlerësuar me 2 pikë.

Vlerësimi në fushën e Qeverisjes së Mirë

Në fushën e Qeverisjes së Mirë, programi i PDK-së paraqet mangësi të theksuara në raport me indikatorët e këtij vlerësimi. Programi nuk përmend depolitizimin e administratës publike, nuk trajton pavarësinë e mediave, si dhe nuk paraqet masa specifike reale për transparencë dhe llogaridhënie qeveritare. Këto tri fusha mbesin jashtë fokusit programor, çka reflektohet drejtpërdrejt në vlerësim.

Sa i përket indikatorit të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, programi e trajton këtë fushë vetëm në mënyrë të kufizuar dhe kryesisht përmes një përmendjeje në raport me përkrahjen e lehonave. Programi thekson se “PDK do të zbatojë politika të posaçme për përkrahjen e lehonave...”, duke përmendur mbështetje financiare, ruajtjen e vendit të punës dhe skema të përbashkëta shtet–punëdhënës. Megjithatë, kjo qasje mbetet e ngushtë: programi as nuk shtrihet në fusha të tjera që lidhen me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave (pjesëmarrja në vendimmarrje, buxhetimi gjinor, mekanizma të zbatimit dhe mbikëqyrjes, masa kundër dhunës me bazë gjinore), e as këtë aspekt nuk e elaboron në mënyrë të strukturuar dhe të matshme. Për këtë arsye, vlerësimi në këtë indikator mbetet minimal.

Në indikatorin e digjitalizimit dhe qeverisjes elektronike, programi i PDK-së e trajton digjitalizimin në disa fusha specifike, si digjitalizimi i drejtësisë, shëndetësisë dhe arsimit. Megjithatë, digjitalizimi nuk trajtohet si reformë e integruar e qeverisjes elektronike, nuk paraqitet

një plan konkret me ndërveprueshmëri të sistemeve, platforma të unifikuara, afate dhe rezultate të pritshme. Për këtë arsye, programi vlerësohet se e trajton këtë indikator vetëm pjesërisht.

Vlerësimi në fushën e Sundimit të Ligjit

Në fushën e Sundimit të Ligjit, programi i PDK-së rezulton me vlerësim edhe më të ulët, kryesisht për shkak se një pjesë e indikatorëve nuk trajtohen fare. Programi nuk thotë asgjë për vetingun në drejtësi, nuk thotë asgjë për korrupsionin, dhe nuk thotë asgjë për rritjen e integritetit dhe reformimin e prokurimit publik. Në raport me prokurimin publik, programi përmban vetëm një përmendje në një kontekst shumë specifik (“Lista e barnave esenciale... do të menaxhohet me transparencë të plotë në prokurim”). Kjo përmendje nuk është e mjaftueshme për të konstatuar se programi e trajton reformën e prokurimit publik qoftë edhe në nivel deklarativ, pasi nuk adreson problemet strukturore të kësaj fushe. Prandaj, në kuptim të indikatorit të prokurimit publik, programi vlerësohet si i paadresuar.

Sa i përket reformës ligjore në sistemin e drejtësisë, programi nuk e trajton këtë fushë përmes një vizioni të qartë dhe masave strukturore të reformimit. Përgjithësisht përmendet Gjykata e Punës, e cila paraqitet pa elaborim të mjaftueshëm lidhur me nevojën, arsyetimin dhe modelin e saj. Përtej kësaj, programi jep zotime të përgjithshme (mos-ndërhyrje, fuqizim, buxhetim), por nuk paraqet reformë: nuk përmend reformën sipas Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve, nuk adreson çështje specifike të ngritura nga Komisioni i Venecias dhe nuk identifikon ligjet që do të reformohen. Për këtë arsye, vlerësimi për këtë indikator mbetet minimal.

Në indikatorin e të drejtave të njeriut, programi përmend vetëm përgjithësisht ndihmën juridike falas dhe disa elemente të tjera që lidhen me zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe trajtimin e personave me nevoja të veçanta. Megjithatë, këto përmendje nuk janë të elaboruara dhe mbeten të paqarta edhe në aspektin e synimit: për zbatimin e vendimeve gjyqësore nuk qartësohet nëse bëhet fjalë për standardizim të zbatimit të standardeve të vendosura nga Gjykatat për të shmangur detyrimin e qytetarëve të ndjekin procedura shtesë në gjykatë apo për zbatimin e vendimeve specifike në raste të caktuara. Po ashtu, për personat me nevoja të veçanta nuk paraqiten masa të strukturuar dhe plane konkrete. Prandaj, edhe ky indikator vlerësohet vetëm në nivel minimal.

Përfundim

Në tërësi, programi politik i PDK-së, në raport me indikatorët e këtij vlerësimi, mbetet i kufizuar si në shtrirje ashtu edhe në nivel elaborimi. Në Qeverisjen e Mirë, programi nuk adreson tri fusha kyçe (depolitizimin e administratës, pavarësinë e mediave dhe llogaridhënien/transparencën qeveritare), ndërsa digjitalizimi trajtohet vetëm sektorialisht dhe pa plan konkret. Në Sundimin e Ligjit, mungon trajtimi i korrupsionit, vetingut dhe prokurimit publik, ndërsa reforma në drejtësi dhe të drejtat e njeriut trajtohen vetëm në nivel të përgjithshëm, pa masa të strukturuar dhe të matshme. Këto mungesa kanë reflektuar drejtpërdrejt në vlerësimin e ulët të programit të PDK-së në të dy shtyllat.

9. Annex 1: Tabela e plotë e vlerësimit

Indikatori	AAK	LDK	LVV	PDK
Barazia gjinore dhe të drejtat e grave në programin qeverisës	3	0	3	1
Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë	3	0	0	0
Depolitizimi i administratës publike	0	3	0	0
Digjitalizimi dhe qeverisja elektronike	3	5	3	3
Pavarësia e mediave	1	0	0	0
Nëntotali – Qeverisja e Mirë (maks. 25)	10	8	6	4
Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë	1	1	1	1
Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit	1	1	0	0
Integriteti i Prokurimit Publik	0	1	1	0
Vetingu në drejtësi	0	0	0	0
Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut	1	0	1	1
Nëntotali – Sundimi i Ligjit (maks. 25)	3	3	3	2
TOTALI I PIKËVE (maks. 50)	13	11	9	6

10. Annex 2: Indikatorët për vlerësimin e programeve të partive politike

I. QEVERISJA E MIRË

Administrata publike, të drejtat e nëpunësve dhe zbatimi i aktgjyqimeve kushtetuese

- 1. Titulli i indikatorit** - Barazia gjinore, të drejtat e grave dhe mbrojtja e grave nga dhuna në familje në programin qeverisës

Përkufizim: Shkalla në të cilën programi trajton të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna në familje si pjesë qendrore të qeverisjes së mirë – me masa konkrete në punësim, pjesëmarrje në vendimmarrje, buxhetim gjinor dhe luftim të dhunës ndaj grave?

Metodologjia: Matet nëse programi parasheh e njeh hapur problemin e pabarazisë gjinore në punësim, në vendimmarrje dhe në qasje në drejtësi;

- parashikon masa konkrete për zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore, përfshirë kuota të qarta dhe mekanizma mbikëqyrës;
- parashikon rritje të pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse në administratë, borde publike dhe ndërmarrje publike;
- parashikon masa konkrete kundër dhunës me bazë gjinore;
- Adreson nevojën për ndërmarrjen e masave për pavarësi ekonomike të grave;
- lidh masat me buxhete të dedikuara dhe afate të qarta.

- 2. Titulli i indikatorit** - Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Qeverisë

Përkufizim: Shkalla në të cilën programi paraqet masa apo veprime strukturore për ngritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në punën e Qeverisë.

Metodologjia: Vlerësohet nëse programi:

- trajton konsultimet publike,
- parasheh publikimin e të dhënave dhe raporteve,
- parasheh transparencë buxhetore dhe të kontraktimit.
- mekanizmave të raportimit publik,
- forcimit të auditorëve të pavarur,

- 3. Titulli i indikatorit** - Depolitizimi i administratës publike

Përkufizim: Masa apo veprime të programit për të kufizuar ndikimin politik në administratën publike.

Metodologjia: Matet nëse programi:

- parasheh rekrutim meritokratik,
- kufizon pozitat ushtruese,
- elaboron çështje specifike në këtë fushë,

- 4. Titulli i indikatorit** - Digjitalizimi dhe qeverisja elektronike

Përkufizim: Shkalla në të cilën programi promovon qeverisjen digjitale përmes shërbimeve digjitale, ndërlidhshmërisë të sistemeve dhe të dhënave të hapura.

Metodologjia: Matet nëse programi:

- parashih platforma të integruara,
- elaboron qeverisjen digjitale,
- adreson ndërveprueshmërinë e sistemeve,
- synon lehtësimin e qasjes së qytetarëve.

5. Titulli i indikatorit - Pavarësia e mediave

Përkufizim: A e trajton programi lirinë e medias si çështje të pavarësisë së KPM dhe RTK, me masa konkrete për financim të qëndrueshëm, emërime meritore dhe mbrojtje të gazetarëve nga presioni politik?

Metodologjia: A e njeh hapur problemin e mungesës së pavarësisë së KPM, RTK dhe presionet ndaj gazetarëve në media;

- Programi e njeh hapur problemin e ndërhyrjeve politike në KPM dhe RTK dhe varësisë financiare të RTK-së nga vendime politike;
- Parashikon model të qartë financimi për RTK-në, që siguron stabilitet afatgjatë dhe e mbron nga presioni politik;
- Adreson problematikat specifike në fushën e lirisë së mediave;
- Parashikon procedura specifike

II. SUNDIMI I RENDIT DHE LIGJIT

1. Titulli i indikatorit - Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë

Përkufizim: A e trajton programi reformën ligjore në drejtësi sipas Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias?

Metodologjia: Matet në bazë të:

- e njeh problematikën, rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe problemet në fushën e reformës në Drejtësi sipas Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve;
- liston ligjet kryesore që do të adresohen,
- parashikon proces të qartë;
- Parashikon zgjidhje të qarta për çështjet problematike të ngritura

2. Titulli i indikatorit – Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit

Përkufizim: A e trajton programi luftimin e korrupsionit si detyrë konkrete të Qeverisë – në fushën e ligjeve, strategjive, rolit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe integritetit institucional?

Metodologjia: e njeh qartë mungesën e kornizës strategjike dhe boshllëqet në zbatimin e ligjeve ekzistuese kundër korrupsionit;

- liston qartë fushat që do të adresohen
- parashikon proces të qartë për:
 - hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit,
 - përfshirjen meritorë të institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile,
- parashikon rritje të qartë të kapaciteteve të APK-së (staf, buxhet);
- parashih masa specifike institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit
- premtun heqje dorë nga përdorimi selektiv dhe politik i diskursit kundër korrupsionit, duke premtuar mos ndërhyrje në sistemin e drejtësisë, qoftë edhe përmes deklaratave publike

3. Titulli i indikatorit - Integriteti i Prokurimit Publik

Përkufizim: A e trajton programi prokurimin publik si fushë të veçantë, me reforma ligjore, kufizim të përdorimit të procedurave një burimore, forcim të institucioneve mbikëqyrëse dhe përdorim të kritereve adekuate?

Metodologjia: e njeh hapur problemin se korniza ligjore e prokurimit publik është vetëm pjesërisht e harmonizuar me nevojat dhe të drejtat e BE-së dhe se prokurimi publik vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj parregullsive, procedurave të planifikuara dobët dhe anashkalimit të procedurave të rregullta, si dhe është përdorur në mënyrë të gjerë procedura një burimore dhe procedurat e mbyllura, me potencial të lartë korruptiv, duke ngritur dyshime serioze për keqpërdorime. Njeh problemet specifike në Ligjin për Prokurimin Publik;

- parashikon masa konkrete për:
 - miratimin brenda afateve të qarta të ligjit të ri për prokurim publik së bashku me aktet nënligjore dhe udhëzimet praktike për zbatim;
 - Përdorimin e procedurave njëburimore vetëm në raste të jashtëzakonshme;
 - Forcimin e mekanizmave institucional në fushën e prokurimit publik;
 - Zhvillimin e mëtejshëm të e-prokurimit;
 - Avancimin e konkureshmërisë në procesin e prokurimit publik;
- nuk premtun masa që nënkuptojnë ndërhyrje direkte në procedura dhe hetime të veçanta (p.sh. “do t’i anulojmë të gjitha kontratat e caktuara” pa bazë ligjore), por fokusohet në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm, transparent dhe konkurrues të prokurimit publik.

4. Titulli i indikatorit - Vetingu në drejtësi

Përkufizim: A e trajton programi çështjen e vetingut në sistemin e drejtësisë?

Metodologjia: A e njeh hapur problemin e mungesës së integritetit dhe besimit në sistemin e drejtësisë dhe paraqet nevojën për zhvillimin e procesit të vettingut;

- Adreson rekomandimet e Komisionit të Venecias;
- Bazohet në ndryshime kushtetuese dhe ligjore;
- Garanton procese të drejtë
- Qartëson mënyrën e arritjes së shumicës së dyfishtë për ndryshimin e kushtetutës për realizimin e procesit të vetingut

5. Titulli i indikatorit – Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Përkufizim: Shkalla në të cilën programi politik trajton mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si pjesë përbërëse të sundimit të rendit dhe ligjit, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe instrumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Metodologjia: Matet nëse programi politik:

- E njeh hapur rolin e Qeverisë për avancimin e administratës publike, që përmes programeve specifike të avancojë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Adreson respektimin dhe zbatimin e drejtëpërdrejtë të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Parasheh masa konkrete për mbrojtjen efektive të të drejtave specifike të njeriut, përfshirë por pa u kufizuar në qasjen në drejtësi, mbrojtjen nga diskriminimi dhe trajtimin e barabartë para ligjit;
- Adreson forcimin e mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Parashikon masa për zbatimin e aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe vendimeve të gjykatave vendore që lidhen me shkelje të të drejtave të njeriut;
- Shmang qasje deklarative dhe paraqet angazhime të matshme, të realizueshme dhe të bazuara në kornizën ligjore ekzistuese.

Poentimi për secilin indikatorë (0–5).

0 = Nuk përmendet;

1 = Deklaratë e përgjithshme;

3 = Përmendet me masa specifike por jo të plotë dhe pa plan të strukturuar zbatim;

5 = Plan gjithëpërfshirë, i qartë dhe i matshëm.

